



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike

AC-I-16-0291

H.K. Gjakovë

Ankuesi/Paditësi

Kundër:

Të paditurat

1. **KBI Gjakovë**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit - AKP**, Rr. "Agim Ramadani",nr.23,Prishtinë.
2. **Komuna**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0147 të datës 13 dhjetor 2016, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 tetor 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. **Ankesa e paditësit, refuzohet si e pabazuar.**

2. Vërtetohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-11-0147 i datës 13 dhjetor 2016.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 18/05/2011, paditësi parashtroi Padi në DHPGJS, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrën kadastrale 4680/01- me kulturë të klasit të pestë me sipërfaqe prej 0.95.15 ha Fleta poseduese 948, Gjakovë. Paditësi pohoi se është trashëgimtar i babit tani të ndjerit I. i cili ishte pronar i pronës në fjalë. Lënda ishte -evidentuar me numrin SCC-11-0147. Paditësi thekson se prona kontestuese ishte transferuar pa ndonjë bazë ligjore në emër të paditurës së dytë (Komuna) dhe më pas nga kjo e paditur tek e paditura e parë (E.). Paditësi më tutje pohoi se prona në fjalë, gjithmonë ka qenë në posedimin e tyre fizik. Padisë i ka bashkangjitur dokumentet si : Ekstrakt nga libri amzë i të vdekurve të I. K. si dhuratëdhënës ka vdekur më 24.07.1959 , Librin amzë i të lindurve H. K. si pasardhës i I. Kerraxhiju , Kontrata për dhurimin në mes te dhuratëdhënësit I. K. dhe dhuratëmarrësit Komuna dt.20/12/1960 , e pa nënshkruar pasi që ka vdekur dhuratëdhënësi para se të jetë nënshkruar, Raportin nga Drejtoria Komunale e Gjeodezisë të dt.19.8.1991, dhe prova të tjera sipas nevojës.

Më 07/06/2011, Paditësi i ka dërguar dokumentet si: Informacionin për paraqitje të padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësi në paluajtshmëri dhe njofton që e ka njoftuar Agjencinë se ka ndërmend të paraqesë padi kundër ndërmarrjes.

Më 25/10/2011,DHPGJS-ja dërgon urdhër paditësit që brenda 14 ditëve të paraqesë, argumente ligjore mbi të cilat bazohet padia kundër, Kuvendit Komunal të Gjakovës, si dhe përkthimin në Anglisht të Vendimit të Komunës nr.01-11952, të cilat i ka paraqitur me datën 09/11/2011.

Me 16/03/ 2012, DHPGJS, lëshoi një Aktvendim me të cilin padia kundër Komunës së Gjakovës refuzohet si e pa pranueshëm me arsyetim se nuk ka asnjë kontest ligjor ndërmjet paditësit dhe Komuna. Kolegji i Apeli me Aktvendimin e nxjerrë më

04 gusht 2016 ankesën e të paditurës kundër Aktvendimit të cekur më parë e hodhi poshtë si të pa pranueshme.

Më 02/05/2012, Agjencia parashtroi mbrojtjen e vetë duke pohuar se paditësit i mungon legjitimiteti aktiv në procedurë, si dhe aspektin e meritave të padisë po ashtu nuk është i bazuar në ligj.

Më 06/06/2012, Paditësi jep kundërpërgjigje duke i vlerësuar pretendimet e të paditurit të pabazuara të gjeneralizuara dhe jo konkrete duke theksuar se ka qenë përherë në posedim dhe shfrytëzim të lirë të paditësit, paditësi pretendon se është pronar i patundshmërisë sipas bazës së trashëgimisë pasi që e drejta e pronësisë nuk ka kaluar në mënyre të rregullt dhe valide në pronësi të paditurës Komunae më pastaj të paditurës "E."

Më 14/09/2012, AKP parashtroi , kundërpërgjigjeje duke pohuar se paditësi i arsyeton veprimet e veta procedural por nuk e dëshmon me Vendim gjyqësor se është shpallur trashëgimtar i të ndjerit. AKP i propozon DHPGJS-së të kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Më 13/12/2016 Kolegji i Specializuar me anë të Aktvendimit e hedhë poshtë padinë e paditësit si të papranueshme me arsyetim se paditësi nuk ka legjitimitet aktiv i njëjti edhe pas urdhrin të lëshuar nga Gjykata nuk e ka paraqitur vendimin e trashëgimisë në gjykatë për të treguar se ka legjitimitete të plotë aktiv.

Më 29/12/2016 paditësi parashtroi ankesë kundër Aktvendimit, SCC-11-0147 të datës 13/12/2016 (më tutje Aktvendimi i ankimuar) për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe propozon që të ndryshoj Aktvendimin duke aprovuar ankesën si të bazuar ose të njëjtin ta prish ose ta kthej në rigjykim duke bashkangjitur dokumentet e parashtruara në shkallë te parë.

Më 07/09/2017 AKP-ja e kundërshton në tërësi ankesën dhe të gjithat pretendimet ankimore të paditësve të parashtruara në ankesën e tyre duke i konsideruara si të pabazuara. Sipas AKP-së ankuesi nuk ka dhënë asnjë arsye ligjore që të mund të përdoret si fakt i cili do të ndikonte në nxjerrjen e Aktvendimit me SCC-11-0147 dt.13.12.2016, më ndryshe për dallim prej atij që është nxjerrë më parë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar .

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës, në bazë të nenit 69.1 i të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Sipas nenit 36 par.2 pika 2.2 të Shtojcës së ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS të Kosovës, një padi është e pranueshme nëse parashtruesi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje par.1 nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Kushti i fundit cituar në nen mund të përmbushet vetëm nëse sigurohet vendimi mbi trashëgiminë.

Paditësi nuk e ka dorëzuar Vendimin e trashëgimisë edhe pse iu është kërkuar nga Kolegji i Specializuar gjë e cila në ato rrethana është e vetmja mënyrë për të konfirmuar të drejtën e tij për të pasur legjitimitet aktiv për të kërkuar njohjen mbi pronën e paraardhësit të tij të lartcekur.

Si rrjedhojë, mungesa e legjitimiteti aktiv juridik çon në refuzim të padis në cilën do fazë të procedurës pasi që paraqet kusht absolut negativ për procedim të mëtejshëm.

Pasi që paditësi ka dështuar që të paraqes Aktvendimin e Trashëgimisë përmes secilit vërtetohet se ai apo edhe dikush tjetër është trashëgimtar i I. K., edhe para Kolegjit të Apelit, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar.

Kolegji i Specializuar ka vlerësuar drejtë për të hedhur poshtë padinë si të papranueshme.

Megjithatë, paditësi mund të parashtroj padi të re kusht që të dorëzoj Aktvendimin e trashëgimisë.

Me sa u than, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi me Aktvendimin e datës 09/03/2017 është liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJ-së më datë 04 tetor 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktvendim tek:

- Ankuesi,
- Tek e paditura,
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën SCC-11-0147.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
